



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**

---

Numri i lëndës: 2019:300229  
Datë: 16.05.2024  
Numri i dokumentit: 05693797

**E.nr.1160/23**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përbarimore të kreditorëve F.M. etj nga Ferizaj, të cilën e përfaqëson av Arian Hetemi nga Lipjani, kundër debitorit Komuna e Ferizajt - Drejtoria Komunale e Arsimit Ferizaj, për pagesën e pagave të papaguara dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 16.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**PËRFUNDON** procedura përbarimore në lëndën **E.nr.1160/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorëve.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.1160/23, të datës 03.08.2023 e ka caktuar përbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit, kundër debitorit Drejtoria Komunale e Arsimit në Ferizaj, për pagesën e pagave të papaguara dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të pajtimit gjyqësor 2019:300230, të dt.23.05.2023.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës, 18.10.2023 e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 2,379.50 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorëve.

Meqenëse kreditorët e kanë realizuar kërkesën e tyre, Gjykata konstaton se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përbarimore në këtë çështje juridike përbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**E.nr.1160/23, më datë 16.05.2024**

**GJYQTARI**  
**Faton Ajvazi**